



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M  
Nr. 7, datë 18.01.2019

**PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 68, DATË 2.10.2018 “PËR MIRATIMIN E  
PËRFAQËSUESVE TË QEVERISJES VENDORE NË BORDET E  
INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 18.01.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në nenin 55 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 1 e nenit 34 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu 3 pika 7 e udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përfaqësuesit të qeverisjes vendore Bashkia Shkodër në bordin e institucionit arsimor “Kolë Idromeno” Bashkia Shkodër si më poshtë:

Nr	Bashkia Shkoder- Institucioni Arsimor	Emri mbiemri i përfaqësuesit	Pozicioni
1	Kolë Idromeno	Xhulio Haxhija	Specialist, Qendra komunitare “Për familjen”, nr. 3

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 18.01.2019  
Shpallur në datën 21.01.2019

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



Xhemal BUSHATI

Pr. 1726. 01.02.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 93/1prot.

Shkodër, më 1.02.2019

**LËNDA:** Lidhur me vendimin Nr.7 dt.18.01.2019 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER.**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit Nr.69/212 “Per sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 34, Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.25 dt.25.7.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të Institucionit Arsimor”, Kreu III, pika 7, *analizoi VKB Nr.7 Dt.18.01.2019 Për një shtesë në VKB Nr.68 dt.2.1.2018 “Për miratimin e përfaqësuesve të qeverisjes vendore në bordet e Institucioneve arsimore të Bashkisë Shkodër, të Z. Xhulio Haxhija pranë Institucionit Arsimor Kole Idromeno”.*

Prefekti u njoh dhe ju autorizon procedimin.

Me respekt,

**P R E F E K T I**

Çesk MILLJA

